



| | |
|---|----------|
|  Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office | |
| E Dërguar: Precedent: Send to: | DLS/DMB |
| Data: Datum: Date: | 26-09-22 |
| Nr. Bë: No: | 247-D-22 |

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2022, miratoi këtë:

UDHËZIM METODOLOGJIK PËR RAPORTIMIN E TREGUESIT TË MBULIMIT ME LIKUIDITET

Data efektive: 1 janar 2023

Qëllimi i këtij udhëzimi metodologjik është të përcaktojë metodologjinë e raportimit të treguesit të mbulimit me likuiditet. Ky udhëzim metodologjik është përpiluar në funksion të zbatimit të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Ky udhëzim metodologjik zbatohet për bankat e licencuara nga BQK, duke përfshirë degët e bankave të huaja.

PJESA 1

ASETET LIKUIDE

1. Udhëzime të përgjithshme

- 1.1. Formulari mbi asetet likuide përmban informacion rreth asetëve për qëllim të raportimit të kërkesës së mbulimit të likuiditetit siç përcaktohet në Rregulloren për treguesin e mbulimit me likuiditet. Zërat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë të hijezuara me ngjyrë të hirtë.
- 1.2. Asetete raportuara do të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.
- 1.3. Bankat do të raportojnë formularin në Euro. Banka do të raportojë ndaras formularin nëse detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës.
- 1.4. Në rast të referimit të Nenit 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, bankat do të raportojnë, aty ku është e rëndësishme, shumën/vlerën e tregut të asetëve likuide duke marrë parasysh neto rrjedhat dalëse dhe hyrëse të likuiditetit që rrjedhin nga një mbyllje e hershme e mbrojtjes (ang. early close-out of hedges) e përcaktuar në Nenin 8 paragrafi 8 dhe në pajtueshmëri me faktorët zvogëlues të duhur të përcaktuar në Kapitullin II.
- 1.5. Rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet i referohet vetëm normave dhe faktorëve zvogëlues (ang. haircuts). Në këto udhëzime fjala “e peshuar” përdoret si term i përgjithshëm për të treguar shumën e fituar pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të caktuar, normave dhe çdo udhëzimi tjetër shtesë me rëndësi (në rast të psh., kreditimit të garantuar dhe financimit). Fjala “peshë” në kontekst të këtyre udhëzimeve i referohet një numri ndërmjet 0 dhe 1, i cili shumëzuar me shumën jep shumën e peshuar ose vlerën sipas Nenit 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.

2. Udhëzime specifike

2.1. Kërkesat specifike lidhur me shlyerjet dhe transaksionet filluese në të ardhmen (ang. settlement and forward starting transactions)

Të gjitha asetet që janë në pajtueshmëri me Nenet 7,8 dhe 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet që janë në zotërim të bankës në datën e referimit do të raportohet në rreshtin e caktuar të Formularit mbi Asetet Likuide të këtij udhëzimi edhe nëse janë shitur ose përdorur në transaksionet e siguruara filluese në të ardhmen. Gjithashtu, asnjë aset likuid nuk do të raportohet në Formularin mbi Asetet Likuide nga transaksionet filluese në të ardhmen (ang. settlement and forward starting transactions) që i referohen blerjeve të aseteve likuide që janë të kontraktuara por ende të pa shlyera dhe blerjeve me pajtim paraprak të aseteve likuide.

2.2. Udhëzimet lidhur me kolonat specifike:

| Kolona | Referencat ligjore dhe udhëzimet |
|---------------|---|
| 1 | <p>Shuma/Vlera e tregut</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 1 vlerën e tregut ose shumën kur është e aplikueshme, të aseteve likuide të përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Shuma/vlera e tregut e raportuar në Kolonën 1:</p> <ul style="list-style-type: none">- do të marrë parasysh rrjedhat dalëse neto dhe rrjedhat hyrëse për shkak të mbylljes së hershme të mbrojtjes të përcaktuar në Nenin 8 paragrafi 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.- nuk do të marrë parasysh faktorët zvogëlues të përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. <p>Në rast të referimit të Nenit 8 paragrafit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, bankat do të marrin parasysh rrjedhën neto të parasë, qoftë rrjedhë dalëse apo hyrëse, që do të rridhte nëse mbrojtja (ang. hedge) do të ishte mbyllur në datën referente të raportimit. Kjo nuk merr parasysh ndryshimet e mundshme në vlerën e ardhshme të asetit.</p> |
| 2 | <p>Pesha standarde</p> <p>Kolona 2 përmban peshat që pasqyrojnë shumën e fituar pas aplikimit të faktorëve zvogëlues përkatës të përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Peshat kanë për qëllim të pasqyrojnë zvogëlimin e vlerës në asetet likuide pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të duhur.</p> |

| | |
|---|--|
| 3 | <p>Pesha e zbatuar</p> <p>Në Kolonën 3, Bankat do të raportojnë peshën e zbatuar në asetet likuide të përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Peshat e zbatuara mund të rezultojnë në vlerat mesatare të peshuara dhe duhet të raportohen në terme decimale (dmth., 1.00 për peshën e zbatueshme prej 100 përqind, ose 0.50 për peshën e zbatueshme prej 50 përqind). Pesha e raportuar në Kolonën 3 nuk duhet të tejkalojë peshën e raportuar në Kolonën 2.</p> |
| 4 | <p>Vlera sipas Nenit 9</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 4 vlerën e asetit likuid në pajtueshmëri me përkufizimin e përcaktuar në Nenin 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Kjo është shuma/vlera e tregut, që merr parasysh rrjedhat dalëse dhe hyrëse neto të likuiditetit për shkak të mbylljes së hershme të mbrojtjes (ang. early close-out of hedges), të shumëzuar me peshën e zbatueshme.</p> |

2.3. Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

| | |
|---|--|
| 1 | <p>1. GJITHSEJ ASETET LIKUIDE TË PARREGULLUARA</p> <p>Kapitulli II i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën / vlerën e tregut të aseteve të tyre likuide në Kolonën 1.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej vlerën sipas Nenit 9 të aseteve të tyre likuide në Kolonën 4.</p> |
| 2 | <p>1.1. Gjithsej asetet e nivelit 1 të parregulluara</p> <p>Neni 10 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e raportuara në këtë pjesë kanë qenë të identifikuar në mënyrë eksplicite ose të trajtuara si Asete të Nivelit 1 kur janë përcaktuar specifikisht në udhëzimet sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën/Vlerën e tregut të Aseteve Likuide të Nivelit 1 në Kolonën 1.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej vlerën sipas Nenit 9 të Aseteve Likuide të Nivelit 1 në Kolonën 4.</p> |

| | |
|---|--|
| 3 | <p>1.1.1. Gjithsej asetet e nivelit 1 të parregulluara</p> <p>Neni 10 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e raportuara në këtë nënseksion kanë qenë të identifikuar në mënyrë eksplicite ose të trajtuara si Asete të Nivelit 1 kur janë përcaktuar specifikisht në udhëzimet sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 1 shumën e gjithsej vlerës së tregut të Aseteve të Nivelit 1, të parregulluar nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 4 shumën e gjithsej shumës së peshuar të Aseteve të Nivelit 1, të parregulluar nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 4 | <p>1.1.1.1. Monedhat dhe kartëmonedhat</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Gjithsej shuma e parasë së gatshme që rrjedh nga monedhat dhe kartëmonedhat.</p> |
| 5 | <p>1.1.1.2. Rezervat e likuiditetit në bankat qendrore që mund të tërhiqen</p> <p>Neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., pika 1.2.3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Rezerva e likuiditetit e mbajtur nga banka në BQK, deri në shumën e lejuar të përdorimit të saj, sipas rregulloreve të BQK-së në fuqi, dhe për filialet apo degët e bankës në vendet e huaja, rezerva e likuiditetit e mbajtur në bankat qendrore të atyre vendeve të përcaktuara në pikën 1.2.2 të nënparagrafit 1.2., deri në shumën e lejuar të përdorimit, siç përcaktohet nga Bankat Qendrore përkatëse.</p> |
| 6 | <p>1.1.1.3. Asetet e Bankës Qendrore</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. pikat 1.2.1. dhe 1.2.2. të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet që përfaqësojnë kërkesat në ose të garantuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës, me përjashtim të aseteve të përcaktuara në pikën 1.2.3. të këtij nënparagrafi;</p> <p>Asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga bankat qendrore të vendeve të huaja, me kusht që ekspozimet ndaj bankës</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>qendrore ose qeverisë qendrore të këtyre vendeve kanë të caktuar një vlerësim kreditor nga një institucion i vlerësimit të jashtëm kreditor (IVJK) i emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 1 në pajtueshmëri me Nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| 7 | <p>1.1.1.4. Asetet e qeverisë qendrore</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. pikat 1.3.1. dhe 1.3.2. të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e qeverisë së Republikës së Kosovës</p> <p>Asetet e qeverisë së një vendi të huaj, me kusht që ka të caktuar një vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 1 në pajtueshmëri me Nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| 8 | <p>1.1.1.5. Asetet e qeverisë rajonale / autoriteteve lokale</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. pika 1.3.3. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në një vend të huaj të llojit të përcaktuar në pikën 1.3.2., me kusht që ato trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore të një vendi të huaj në pajtueshmëri me Nenin 45 paragrafi 3 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| 9 | <p>1.1.1.6. Asetet e entitetit të sektorit publik</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. pika 1.3.4. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Entitetet e sektorit publik me kusht që trajtohen si ekspozime ndaj një nga qeveritë rajonale apo autoritetet lokale të përcaktuara në pikën 1.3.3. në pajtueshmëri me Nenin 46, paragrafi 6 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| 10 | <p>1.1.1.7. Asetet e njohura të qeverisë qendrore dhe të bankës qendrore në valutë vendore dhe të huaj</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4., 1.4.2. dhe 1.4.3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>1.4.1. Asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj ku banka operon përmes një filiale ose një dege, të cilave nuk i është caktuar</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>vlërësimi kreditor i shkallës së cilësisë kreditore 1 nga një IVJK e emëruar në pajtueshmëri me Nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> <p>1.4.2. rezervat e detyrueshme e likuiditetit që mbahet nga banka në një bankë qendrore të përcaktuar në pikën 1.4.1., deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sikurse përcaktohet nga Bankat Qendrore përkatëse.</p> <p>1.4.3. shuma agregate e asetëve që mund të përfshihen në kuadër të pikave 1.4.1 dhe 1.4.2., dhe të denominuara në valutën e caktuar që banka mund t'i njohë si Asete të Nivelit 1 nuk duhet të tejkalojnë shumën e neto rrjedhave dalëse të stresuara të likuiditetit të ndodhura të bankës në valutën e njëjtë. Gjithashtu, në rastet kur një pjesë ose të gjitha asetet që mund të përfshihen në kuadër të pikave 1.4.1 dhe 1.4.2 janë të denominuara në një valutë që nuk është valutë vendore e vendit të huaj në fjalë, banka mund të njohë ato asetë si Asete të Nivelit 1 deri në shumën që është e barabartë me shumën e neto rrjedhave dalëse të stresuara të likuiditetit të ndodhura në atë valutë të huaj që korrespondon me operacionet e bankës në juridiksionin ku merret rreziku i likuiditetit.</p> |
| 11 | <p>1.1.1.8. Asetet e bankave shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatave ndërkombëtare</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në Nenin 47, paragrafi 3 dhe Nenin 48 të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| 12 | <p>1.2. Gjithsej asetet e Nivelit 2 të parregulluara</p> <p>Nenet 11 dhe 12 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e raportuara në këtë pjesë kanë qenë të identifikuar në mënyrë eksplicite si, ose të trajtura ngjashëm me asetet e Nivelit 2A ose Nivelit 2B sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën/Vlerën e tregut të Aseteve Likuide të Nivelit 2 në Kolonën 1.</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej vlerën sipas Nenit 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet të Aseteve Likuide të Nivelit 2 në Kolonën 4.</p> |

| | |
|----|--|
| 13 | <p>1.2.1. Gjithsej asetet e Nivelit 2A të parregulluara</p> <p>Neni 11 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e raportuara në këtë nën-seksion kanë qenë të identifikuar në mënyrë eksplicite si, ose të trajtuara si asetet e Nivelit 2A.</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 1 shumën e gjithsej vlerës së tregut të aseteve të Nivelit 2A, të parregulluar nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 4 shumën e gjithsej shumës së peshuar të aseteve të Nivelit 2A, të parregulluar nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 14 | <p>1.2.1.1. Asetet e Bankës Qendrore ose qeverisë qendrore/rajonale ose autoritetet lokale ose të Entiteteve të Sektorit Publik (Pesha e Rrezikut 20%)</p> <p>Neni 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj ose nga një qeveri rajonale, autoritet lokal ose entitet i sektorit publik në një vend të huaj, me kusht që kanë të caktuar peshën e rrezikut prej 20% në pajtueshmëri me Nenet 44, paragrafi 2, Nenin 45 paragrafi 2 dhe Nenin 45 paragrafi 4 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave., siç është e aplikueshme.</p> |
| 15 | <p>1.2.1.2. Letrat me vlerë të borxhit të korporatave</p> <p>Neni 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të korporatave që janë në pajtueshmëri me Nenin 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.</p> |
| 16 | <p>1.2.2. Gjithsej asetet e Nivelit 2B të parregulluara</p> <p>Neni 12 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet e raportuara në këtë nënseksion në mënyrë eksplicite kanë qenë të identifikuar si Asete në Nivelit 2B sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 1 shumën e gjithsej vlerës së tregut të Aseteve të Nivelit 2B, të parregulluara nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 4 shumën e gjithsej shumës së peshuar të asetëve të Nivelit 2B, të parregulluar nga dispozita e Nenit 13 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 17 | <p>1.2.2.1. Letrat me vlerë të borxhit të korporatave</p> <p>Neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Letrat me vlerë të borxhit të korporatave që janë në pajtueshmëri me Nenin 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.</p> |
| 18 | <p>1.2.2.2. Asetet e bankës qendrore ose të qeverisë qendrore</p> <p>Neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga bankat qendrore ose qeveritë qendrore të një vendi të huaj, me kusht që kanë të caktuar një vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 3 në pajtueshmëri me Nenin 44, paragrafi 2, të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |
| | ZËRA MEMORANDUMI |
| 19 | <p>3. Asetet e Nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për arsye valutore</p> <p>Neni 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Banka do të raportojë pjesën e asetëve që janë në pajtueshmëri me Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4., që nuk janë njohur nga banka sipas dispozitave të përcaktuara në këtë nen.</p> |
| 20 | <p>4. Asetet e Nivelit 1/2A/2B të përjashtuara për arsye operationale përveç për arsye valutore</p> <p>Neni 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë asetet që janë në pajtueshmëri me Nenin 7 por që nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Nenin 8, me kusht që nuk janë raportuar në rreshtin 19 për arsye valutore.</p> |

PJESA 2

RRJEDHAT DALËSE

1. Udhëzime të përgjithshme

- 1.1. Formulari mbi rrjedhat dalese përmban informacion rreth rrjedhave dalëse të likuiditetit të matura përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, për qëllim të raportimit të kërkesës së mbulimit me likuiditet. Zërat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë të hijezuara me ngjyrë të hirtë.
- 1.2. Bankat do të raportojnë formularin në Euro. Banka do të raportojë ndaras formularin nëse detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës.
- 1.3. Disa zëra memorandumi janë të përfshirë në formularin shoqërues në këto udhëzime. Ndërsa nuk janë rreptësisht të domosdoshme për llogaritjen e vetë raportit, kërkohet të plotësohen. Këta zëra ofrojnë informacion të nevojshëm për t'i mundësuar BQK-së që të bëjë një vlerësim adekuat të pajtueshmërisë së bankave me kërkesat e likuiditetit. Në disa raste këta zëra paraqesin një ndarje më të madhe të zërave të përfshirë në seksionet kryesore të formularëve ndërsa në raste tjera pasqyrojnë burime shtesë të likuiditetit që bankat mund të kenë qasje në to.
- 1.4. Në pajtueshmëri me Nenin 17 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, rrjedhat dalëse të likuiditetit do të:
 - 1.4.1. përfshijnë kategoritë e përcaktuara në Nenin 17 paragrafi 2.
 - 1.4.2. llogariten duke shumëzuar bilancet e mbetura të kategorive të ndryshme të detyrimeve dhe zotimve jashtëbilancore me normat që ato pritet të tërhiqen ose të përdoren siç parashihet në Rregullore.
- 1.5. Rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet i referohet vetëm normave dhe faktorëve zvogëlues (ang. haircuts) dhe fjala “peshë” vetëm se i referohet këtyre. Në këto udhëzime fjala “e peshuar” përdoret si term i përgjithshëm për të treguar shumën e fituar pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të caktuar, normave dhe çdo udhëzimi tjetër shtesë me rëndësi (në rast të p.sh., kreditimit të siguruar dhe financimit).
- 1.6. Rrjedhat dalëse të likuiditetit do të raportohen vetëm njëherë në formular përveç nëse rrjedhat dalëse shtesë sipas Nenit 23 të Rregullores janë të aplikueshme ose kur zëri është një “prej të cilave” zë ose një zë memorandumi.

- 1.7. Në rast të raportimit të ndarë nga banka në valutë të huaj, gjithnjë do të zbatohen pikat si në vijim:
 - 1.7.1. vetëm zërat dhe rrjedhat e denominuara në atë valutë do të raportohen;
 - 1.7.2. në rast të mospërputhjes valutore ndërmjet anëve të transaksionit, vetëm ana në atë valutë do të raportohet;
 - 1.7.3. në rast kur lejohet netimi sipas Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet mund të aplikohet vetëm ndaj rrjedhave në atë valutë;
 - 1.7.4. në rast kur rrjedha ka opsione shumëvalutore, banka do të bëjë një vlerësim të valutës në të cilën rrjedha është e mundur të ndodhë dhe do të raportojë zërin vetëm në atë valutë të ndarë.
 - 1.8. Peshat standarde në kolonën 4 të formularit Mbi Rrjedhat Dalëse janë ato të përcaktuara në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe janë të paraqitura në formular për informim.
 - 1.9. Formulari përmban informacion rreth rrjedhave të kolateralizuara të likuiditetit, të përcaktuara si “kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit” në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, dhe për qëllim të llogaritjes së treguesit të mbulimit me likuiditet siç përkufizohet në rregullore. Në rast kur këto transaksione realizohen kundrejt një grumbulli me kolateral, identifikimi i aseteve specifike të lëna peng për qëllim të raportimit në këtë formular do të bëhet sipas kategorive të aseteve likuide siç përkufizohet në Kapitullin II, Nënkapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, duke filluar nga aseti me likuiditetin më të ulët. Njëkohësisht në rast të transaksioneve me maturitet të ndryshëm të mbetur të bëra kundrejt grumbullit të kolateralit, së pari, më pak asete likuide i caktohen transaksioneve me maturitetin më të gjatë të mbetur.
 - 1.10. Një formular i ndarë është ofruar për “Kundërkëmbimet e kolateralit”. Kundërkëmbimet e kolateralit, që janë transaksione kolateral kundrejt kolateralit nuk do të aplikohen në formularin mbi Rrjedhat Dalëse që mbulon vetëm transaksionet para të gatshshme kundrejt kolateralit.
2. Udhëzime specifike lidhur me shlyerjet dhe transaksionet filluese në të ardhmen (ang. forward starting transactions).
 - 2.1. Bankat do të raportojnë rrjedhat dalëse që burojnë nga marrëveshjet riblerëse që fillojnë në të ardhmen, marrëveshjet riblerëse të ndërsjellta dhe kundërkëmbimet e kolateralit që fillojnë brenda një periudhe 30 ditore dhe maturojnë përtej një periudhe 30 ditore ku ana fillestare prodhon një rrjedhë dalëse. Në rastin e një marrëveshjeje riblerëse të ndërsjelltë, shuma që duhet të jepet hua ndaj kundërpalës do të konsiderohet si një rrjedhë dalëse dhe raportohet në zërin 1.1.8.5 neto nga vlera e tregut të asetit që pritet të merret si kolateral dhe pas

aplikimit të faktorëve zvogëlues të Treguesit të Mbulimit me Likuiditet nëse asetit kualifikohet si aset likuid. Nëse shuma që duhet të jepet hua është më e ulët sesa vlera e tregut të asetit (pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të TML) që do të merret si kolateral, diferenca do të raportohet si një rrjedhë hyrëse. Nëse kolaterali që do të merret nuk kualifikohet si aset likuid, rrjedha dalëse do të raportohet në tërësi. Në rastin e një marrëveshje riblerëse, kur vlera e tregut të asetit që duhet të jepet hua si kolateral pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të TML (nëse asetit kualifikohet si aset likuid) është më e madhe se shuma e parave të gatshme që do të merret, diferenca do të raportohet si rrjedhë dalëse në rreshtin e përmendur më lartë. Nëse shuma që do të merret është më e madhe sesa vlera e tregut të asetit (pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të TML) që do të huazohet si kolateral, diferenca do të raportohet si një rrjedhë hyrëse. Për kundërkëmbimet e kolateralit, kur efekti neto i këmbimit fillestar i aseteve likuide (duke marrë parasysh faktorët zvogëlues të TML) krijon një rrjedhë dalëse, kjo rrjedhë dalëse do të raportohet në rreshtin e përmendur më lartë. Marrëveshjet riblerëse me pajtim paraprak, marrëveshjet riblerëse të ndërsjellta me pajtim paraprak dhe kundërkëmbimet e kolateralit me pajtim paraprak që fillojnë dhe maturojnë gjatë periudhës 30 ditore të TML nuk kanë ndonjë ndikim në TML të bankës dhe mund të mos merren parasysh.

2.2. Udhëzimet lidhur me kolonat specifike

| Kolona | Referencat ligjore dhe udhëzimet |
|--------|---|
| 1 | <p>Shuma</p> <p>1.1. Udhëzimet specifike për transaksionet/depozitat e pasiguruara:</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu bilancin e mbetur të kategorive të ndryshme të detyrimeve dhe zotimeve jashtëbilancore siç janë specifikuar në Nenet 17 deri 24 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>1.2. Udhëzimet specifike për kreditimin e siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit:</p> <p>Bankat do të raportojnë bilancin e mbetur të detyrimeve në pajtueshmëri me Nenin 17 paragrafin 2 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, që përfaqëson anën e parasë së gatshme të transaksionit të siguruar (ang. secured).</p> |
| 2 | <p>Vlera e tregut e kolateralit të lejuar</p> <p>Udhëzimet specifike për kreditimin e siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë këtu vlerën e tregut të kolateralit të lejuar që llogaritet si vlera aktuale e tregut bruto nga faktorët zvogëlues dhe neto nga rrjedhat që rezultojnë nga mbrojtjet e lidhura (në pajtueshmëri me Nenin 8 paragrafi 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe që janë subjekt i kushteve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në rastin kur banka mund të njohë vetëm një pjesë të aseteve të qeverisë qendrore ose bankës qendrore në valutë të huaj, ose të aseteve të qeverisë qendrore ose të bankës qendrore në valutë vendore në kuadër të rezervës së likuiditetit, vetëm pjesa e njohur do të raportohet në kuadër të rreshtave të Niveleve 1, 2A dhe 2B (në pajtueshmëri me Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4. të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Në rastin kur një aset i caktuar përdoret si kolateral por në një shumë që është tepriçë për pjesën që mund të njihet në kuadër të aseteve likuide, shuma e tepriçës do të raportohet në zërin jo-likuid; - Asetet e Nivelit 2A do të raportohen në rreshtin korrespondues të aseteve të Nivelit 2A (d.m.th., që në raportimin e transaksioneve të siguruara nuk duhet lëvizur Niveli i aseteve 2A në Nivelin 1). |
| 3 | <p>Vlera e kolateralit të lejuar sipas Nenit 9</p> <p>Udhëzimet specifike për kreditimin e siguar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit:</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu vlerën e kolateralit të lejuar në pajtueshmëri me Nenin 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Kjo llogaritet duke shumëzuar Kolonën 2 të formularit mbi Rrjedhat Dalëse me peshën/faktorin zvogëlues të aplikueshëm nga formulary 1 që korrespondon me llojin e asetit.</p> <p>Kolona 3 e formularit mbi Rrjedhat Dalëse përdoret në llogaritjen e shumës së korigjuar të aseteve likuide në formularin mbi Llogaritjet.</p> |
| 4 | <p>Pesha standarde</p> <p>Nenet 19-24 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Peshat standarde në Kolonën 4 janë ato të përcaktuara në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe janë të dhëna vetëm për qëllim të informimit.</p> |

| | |
|---|--|
| 5 | <p>Pesha e zbatuar</p> <p>Peshat e pasiguruara dhe të siguruara</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu peshat e zbatuara. Këto pesha janë përcaktuar në Nenet 17 deri në 24 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Peshat e zbatuara mund të rezultojnë në vlerat mesatare të peshuara dhe duhet të raportohen në terme decimale (dmth., 1.00 për peshën e zbatueshme prej 100 përqind, ose 0.50 për peshën e zbatuar prej 50 përqind). Peshat e zbatuara mund të pasqyrojnë, por nuk janë të kufizuara në specifikat e bankës.</p> |
| 6 | <p>Rrjedha dalëse</p> <p>Rrjedhat dalëse të pasiguruara dhe të siguruara:</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse. Këto llogariten duke shumëzuar Kolonën 1 në formularin mbi Rrjedhat Dalëse me Kolonën 5 në formularin mbi Rrjedhat Dalëse.</p> |

2.3. Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

| Rreshti | Referencat ligjore dhe udhëzimet |
|----------------|---|
| 1 | <p>1. RRJEDHAT DALËSE</p> <p>Nënkapitulli II i Kapitullit III të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi rrjedhat dalëse në pajtueshmëri me Nënkapitullin II të Kapitullit III.</p> |
| 2 | <p>1.1. Rrjedhat dalëse nga transaksionet /depozitat e pasiguruara</p> <p>Neni 15 deri në 24 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi rrjedhat dalëse në pajtueshmëri me Nenet 16 deri në 24 me përjashtim të rrjedhave dalëse në pajtueshmëri me Nenin 22 paragrafët 4 dhe 5.</p> |
| 3 | <p>1.1.1. Depozitat me pakicë (ang. retail deposits)</p> <p>Nenet 19 dhe 20 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi depozitat me pakicë (ang. retail).</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Në pajtueshmëri me Nenin 22 paragrafi 6 bankat gjithashtu do të raportojnë në kuadër të kategorisë së duhur të depozitave me pakicë shumën e vlerënotave, obligacioneve dhe letrave tjera me vlerë të emetuara që janë shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë (ang. retail market) dhe që mbahen në llogarinë me pakicë.</p> <p>Bankat do të marrin parasysh për këtë kategori të detyrimeve normat e rrjedhave dalëse të aplikueshme për kategoritë e ndryshme të depozitave me pakicë.</p> <p>Prandaj, bankat do të raportojnë si peshë të zbatuar mesataren e peshave relevante të zbatuara për të gjitha këto depozita.</p> |
| 4 | <p>1.1.1.1. depozitat e përjashtuara nga llogaritja e rrjedhave dalëse</p> <p>Neni 20 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ato kategori të depozitave me pakicë që janë të përjashtuara nga llogaritja e rrjedhave dalëse nëse kushtet e Neni 20 paragrafi 5 nënparagrafët 5.1 ose 5.2 janë plotësuar.</p> |
| 5 | <p>1.1.1.2. depozitat për të cilat është përcaktuar marrëveshja për pagesë brenda 30 ditëve në vijim</p> <p>Neni 20 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu depozitat me maturitet të mbetur më të vogël se 30 ditë ku pagesa është përcaktuar.</p> |
| 6 | <p>1.1.1.3. depozitat subjekt i rrjedhave dalëse më të larta</p> <p>Neni 20 paragrafi 2 dhe paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu bilancin e plotë të depozitave që janë subjekt i normave më të larta të rrjedhave dalëse në pajtueshmëri me paragrafin 2 dhe 3 të Neni 20. Ato depozita me pakicë ku vlerësimi sipas paragrafit 2 të Neni 20 për kategorizimin e tyre nuk është kryer ose nuk është plotësuar gjithashtu do të raportohet këtu.</p> |

| | |
|---|---|
| 7 | <p>1.1.1.3.1. Kategoria 1</p> <p>Neni 20 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e gjithë bilancit të mbetur të çdo depozite me pakicë që i plotëson kriteret në nënparagrafin 2.1 ose dy nga kriteret në nënparagrafin 2.2 deri në 2.5 të paragrafit 2 të Nenit 20 përveç nëse këto depozita janë marrë në vende të huaja ku aplikohet një rrjedhë dalëse më e lartë në pajtueshmëri me Nenin 20 paragrafi 8 në të cilin rast do të raportohen në kuadër të kësaj kategorie të fundit.</p> <p>Bankat do të raportojnë si peshë të zbatuar mesataren e normave, ose ato norma standarde të përcaktuara me rregullore në nënparagrafin 3.1 të paragrafit 3 të Nenit 20 ose normave më të larta nëse aplikohen nga autoriteti mbikëqyrës kompetent, që kanë qenë të zbatuara në mënyrë efektive në shumën e plotë të çdo depozite të përcaktuar në paragrafin e mësipërm dhe të peshuar nga shumat korresponduese të përcaktuara.</p> |
| 8 | <p>1.1.1.3.2. Kategoria 2</p> <p>Neni 20 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e gjithë bilancit të mbetur të çdo depozite me pakicë që i plotëson kriteret në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të Nenit 20 dhe së paku një kriter tjetër të përcaktuar në paragrafin 2 ose tri apo më tepër kriteret të të njëjtit paragrafi përveç nëse këto depozita janë marrë në vende të huaja ku aplikohet një rrjedhë dalëse më e lartë në pajtueshmëri me Nenin 20 paragrafi 8 në të cilin rast do të raportohen në kuadër të kësaj kategorie të fundit.</p> <p>Ato depozita me pakicë ku vlerësimi sipas paragrafit 2 të Nenit 20 për kategorizimin e tyre nuk është kryer ose nuk është përfunduar gjithashtu duhet të raportohet këtu.</p> <p>Bankat do të raportojnë si peshë të aplikueshme mesataren e normave, ose ato norma standarde të përcaktuara me rregullore në nënparagrafin 3.2 të paragrafit 3 të Nenit 20 ose normave më të larta nëse aplikohen nga autoriteti mbikëqyrës kompetent, që kanë qenë të zbatuara në mënyrë efektive në shumën e plotë të çdo depozite të përcaktuar në paragrafin e mësipërm dhe të peshuar nga shumat korresponduese të përcaktuara.</p> |

| | |
|----|--|
| 9 | <p>1.1.1.4. depozitat e qëndrueshme</p> <p>Neni 19 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e shumave të depozitave me pakicë të mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj, dhe është pjesë e një marrëdhënieje të themeluar që e bënë tërheqjen mjaftë të pamundur ose mbahet në llogari të transaksioneve në pajtueshmëri me Nenin 19 paragrafit 2 dhe 3 dhe ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këto depozita nuk i plotësojnë kriteret për një normë më të lartë të rrjedhës dalëse në pajtueshmëri me Nenin 20 paragrafi 2, 3 ose 8 në të cilin rast do të raportohen si depozitat që janë subjekt i rrjedhave dalëse më të larta; ose - Këto depozita nuk janë marrë në vende të huaja ku një rrjedhë dalëse më e lartë është aplikuar në pajtueshmëri me Nenin 20 paragrafi 8 në të cilin rast do të raportohen në kuadër të kësaj kategorie; |
| 10 | <p>1.1.1.5. depozitat në vendet e huaja ku aplikohet një normë më e lartë e rrjedhës dalëse</p> <p>Neni 20 paragrafi 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e depozitave me pakicë të marra në vendet e huaja ku është aplikuar një normë më e lartë e rrjedhës dalëse në pajtueshmëri me ligjin vendor që rregullon kërkesat e likuiditetit në atë vend të huaj.</p> |
| 11 | <p>1.1.1.6. depozitat tjera me pakicë</p> <p>Neni 20 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e depozitave tjera me pakicë përveç atyre të mbuluara në zërat e mësipërm.</p> |
| 12 | <p>1.1.2. Depozitat operacionale</p> <p>Neni 21 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë këtu pjesën e depozitave operacionale, në pajtueshmëri me Nenin 21, që është i nevojshëm për dispozitën e shërbimeve operacionale. Depozitat që realizohen nga marrëdhënia e bankingut korrespondet ose nga dispozita e shërbimeve të brokerimit primar do të konsiderohen depozita jo-operacionale në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 4.</p> <p>Pjesa e depozitave operacionale që tejkalon shumën e nevojshme për dispozitën e shërbimeve operacionale nuk do të raportohet këtu por në zërin 1.1.3.</p> |
| 13 | <p>1.1.2.1. Depozitat e mbajtura për kliring, kujdestari, me naxhim të parasë së gatshme ose shërbime të ngjashme të krahasueshme në kontekst të marrëdhënies operacionale të krijuar</p> <p>Neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., Neni 21 paragrafi 2 dhe Neni 21 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu depozitat e mbajtura nga depozituesi në mënyrë që të përfitojë shërbimet e kliringut, kujdestarisë, menaxhimit të parasë së gatshme ose shërbimet e ngjashme të krahasueshme në kontekst të një marrëdhënie të krijuar në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. që është me rëndësi kritike për depozituesin (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3; fondet që tejkalojnë shumën e kërkuar për dispozitën e shërbimeve operacionale trajtohen si depozita jo-operacionale (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3).</p> <p>Vetëm depozitat që kanë kufizime të konsiderueshme ligjore ose operacionale që i bëjnë të pamundura tërheqjet e konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3) do të raportohen.</p> <p>Bankat do të raportojnë ndaras, në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 2, shumën e këtyre depozitave të mbuluara dhe të pambuluara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë garantuese e depozitave ekuivalente në një vend të huaj, siç përcaktohet në zërat në vijim të udhëzimeve.</p> |
| 14 | <p>1.1.2.1.1. Depozitat e mbuluara nga Skema e Garantimit të Depozitave</p> <p>Neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., Neni 21 paragrafi 2 dhe Neni 21 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë pjesën e bilancit të mbetur të depozitave operacionale të mbajtura në kontekst të marrëdhënieve operacionale të krijuara, që plotëson kriterin e përcaktuar në Nenin 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe Neni 21 paragrafi 3 dhe që është i mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj.</p> |
| 15 | <p>1.1.2.1.2. Depozitat e pambuluara nga një Skemë e Garantimit të Depozitave</p> <p>Neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., Neni 21 paragrafi 2 dhe Neni 21 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e bilancit të mbetur të depozitave operacionale të mbajtura në kontekst të marrëdhënieve operacionale të krijuara, që plotëson kriterin e përcaktuar në Nenin 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe Neni 21 paragrafi 3 dhe që nuk është i mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj.</p> |
| 16 | <p>1.1.2.2. Depozitat e mbajtura në kontekst të një marrëdhënie (tjetër) operacionale të krijuar me klientët jo-financiar</p> <p>Neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., Neni 21 paragrafi 3 dhe Neni 21 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të depozitave të mbajtura nga një klient jo-financiar në kontekst të një marrëdhënieje operacionale të krijuar përveç asaj marrëdhënie të përmendur në Nenin 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., dhe që është subjekt i kërkesave të përcaktuara në Nenin 21 paragrafi 5.</p> <p>Vetëm depozitat që kanë kufizime të konsiderueshme ligjore ose operacionale që i bëjnë të pamundura tërheqjet e konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3) do të raportohen.</p> |
| 17 | <p>1.1.2.3. Depozita të mbajtura për të përfituar kliring të parasë së gatshme</p> <p>Neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. dhe Neni 21 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të depozitave të mbajtura nga depozituesi për të përfituar kliring të parasë së gatshme, siç përcaktohet në Nenin 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2.</p> <p>Kliringu i parasë së gatshme mbulon vetëm shërbimet e tilla në masën që ato shërbime janë të kryera në kontekst të marrëdhënies së krijuar që është me rëndësi kritike për depozituesin (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3; fondet që tejkalojnë shumën e kërkuar për dispozitën e shërbimeve operacionale trajtohen si depozita jo operacionale (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3).</p> <p>Vetëm depozitat që kanë kufizime të konsiderueshme ligjore ose operacionale që i bëjnë të pamundura tërheqjet e konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike (në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3) do të raportohen.</p> |
| 18 | <p>1.1.3 Depozitat operacionale tepricë</p> <p>Neni 21 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu pjesën e depozitave operacionale që tejkalojnë shumën e kërkuar për dispozitën e shërbimeve operacionale.</p> |
| 19 | <p>1.1.3.1 depozitat nga klientët financiar</p> <p>Neni 21 paragrafi 3 dhe Neni 24 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e depozitave operacionale nga klientët financiar që tejkalojnë shumën e kërkuar për dispozitën e shërbimeve operacionale në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3.</p> |
| 20 | <p>1.1.3.2 Depozitat nga klientët tjerë</p> <p>Neni 21 paragrafi 3 dhe Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e depozitave operacionale nga klientët e ndryshëm nga klientët financiar, dhe duke përjashtuar depozitat me pakicë, që tejkalojnë shumën e kërkuar për dispozitën e shërbimeve operacionale në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 3.</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Këto depozita operacionale të tepërta do të raportohen në dy rreshta të ndryshëm varësisht nëse ose jo e gjithë shuma e depozitës operacionale të tepërt është e mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj.</p> |
| 21 | <p>1.1.3.2.1 Depozitat e mbuluara nga Skema e Garantimit të Depozitave</p> <p>Neni 21 paragrafi 3 dhe Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e bilancit të mbetur të depozitave operacionale shtesë të mbajtura nga klientët tjerë nëse ajo shumë është e mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 1.</p> |
| 22 | <p>1.1.3.2.2 Depozitat e pambuluara nga Skema e Garantimit të Depozitave</p> <p>Neni 21 paragrafi 3 dhe Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e bilancit të mbetur të depozitave operacionale shtesë të mbajtura nga klientët tjerë nëse ajo shumë nuk është e mbuluar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 1.</p> |
| 23 | <p>1.1.4. Depozitat jo-operacionale</p> <p>Neni 21 paragrafi 4 dhe Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi depozitat e pasiguruara të përcaktuara në Nenin 22 paragrafi 1 dhe ato që realizohen nga bankingu korrespondent ose nga dispozita e shërbimeve të brokerimit primar në pajtueshmëri me Nenin 21 paragrafi 4.</p> <p>Bankat do të raportojnë ndaras, me përjashtim të detyrimeve që realizohen nga marrëdhënia e bankingut korrespondent ose nga dispozita e shërbimeve të brokerimit primar në pajtueshmëri me</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Nenin 21 paragrafi 4, depozitat jo-operacionale të siguruara dhe të pasiguruara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë garantuese e depozitave ekuivalente në një vend të huaj siç përcaktohet në zërat në vijim të udhëzimeve.</p> <p>Pjesa e depozitave operacionale të tepërta nga ato që kërkohen për dispozitën e shërbimeve operacionale nuk do të raportohen këtu por do të raportohen sipas zërit 1.1.3.</p> |
| 24 | <p>1.1.4.1. bankingu korrespondent dhe dispozita e depozitave të brokerimit primar</p> <p>Neni 21 paragrafi 4 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të depozitave që realizohen nga marrëdhënia e bankingut correspondent ose nga dispozita e brokerimit primar siç përcaktohet në Nenin 21 paragrafi 4.</p> |
| 25 | <p>1.1.4.2. depozitat nga klientët financiar</p> <p>Neni 24 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilanceve të mbetura të depozitave të mbajtura nga klientët financiar në masën që ato nuk konsiderohen si depozita operacionale në pajtueshmëri me Nenin 21.</p> |
| 26 | <p>1.1.4.3. depozitat nga klientët tjerë</p> <p>Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi depozitat e mbajtura nga klientët tjerë (të ndryshëm nga klientët financiar dhe klientët që konsiderohen për depozitat me pakicë) në pajtueshmëri me Nenin 22 paragrafi 1, në masën që ato nuk konsiderohen si depozita operacionale në pajtueshmëri me Nenin 21.</p> <p>Këto depozita do të raportohen në dy rreshta të ndryshëm pavarësisht nëse gjithsej shuma e depozitit është e siguar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj.</p> |
| 27 | <p>1.1.4.3.1. depozitat e mbuluara nga një skemë e garantimit të depozitave</p> <p>Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën e bilancit të mbetur të këtyre depozitave të mbajtura nga klientët tjerë nëse ajo shumë e plotë është e siguruar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 1.</p> |
| 28 | <p>1.1.4.3.2. depozitat e pambuluara nga një skemë e garantimit të depozitave</p> <p>Neni 22 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën e bilancit të mbetur të këtyre depozitave të mbajtura nga klientët tjerë nëse ajo shumë e plotë nuk është e siguruar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose nga një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 1.</p> |
| 29 | <p>1.1.5. Rrjedhat dalëse shtesë</p> <p>Neni 23 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi rrjedhat dalëse shtesë siç përkufizohen në Nenin 23. Në pajtueshmëri me Nenin 23 paragrafi 9 depozitat e marra si kolateral nuk do të konsiderohen si detyrime për qëllim të Nenit 19, 20, 21, 22 ose 24 paragrafi 7 dhe 8 por do të jenë subjekt i dispozitave të paragrafëve 1 deri në 8 të Nenit 23, ku është e aplikueshme. Shuma e parasë së gatshme e pranuar që tejkalon shumën e parasë së gatshme të pranuar si kolateral do të trajtohet si depozita në pajtueshmëri me Nenin 19, 20, 21, 22 ose 24 paragrafi 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje.</p> |

| | |
|----|---|
| 30 | <p>1.1.5.1. kolaterali i postuar për derivativët i ndryshëm nga asetet e Nivelit 1</p> <p>Neni 23 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të kolateralit të ndryshëm nga kolaterali i asetëve të Nivelit 1 që është postuar për kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe derivativët kreditor.</p> |
| 31 | <p>1.1.5.2. rrjedhat dalëse materiale për shkak të përkeqësimit të kualitetit kreditor të vetë bankës</p> <p>Neni 23 paragrafi 2 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë gjithsej shumën e rrjedhave dalëse shtesë që kanë llogaritur dhe njoftuar tek bankat qendrore ose autoritetet rregullatore në pajtueshmëri me Nenin 23 paragrafi 2.</p> <p>Nëse një shumë që është subjekt i rrjedhës dalëse për shkak të përkeqësimit të kualitetit kreditor të vetë bankës është raportuar diku tjetër në një rresht me peshë më të ulët se 100%, pastaj një shumë gjithashtu do të raportohet në Rreshtin 31 në mënyrë që shuma e rrjedhave dalëse është gjithsej 100% rrjedhë dalëse për transaksionin.</p> |
| 32 | <p>1.1.5.3. ndikimi i një skenari negativ të tregut në transaksionet derivative</p> <p>Neni 23 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e rrjedhave dalëse të llogaritur si në vijim:</p> <p>Transaksionet derivative të bankës do të konsiderohen materiale kur gjithsej shumat nocionale të transaksioneve të tilla ka tejkaluar 10% të rrjedhave dalëse neto të likuiditetit në çdo kohë gjatë dy viteve paraprahe.</p> <p>Rrjedha dalëse neto e likuiditetit do të llogaritet pa elementin e rrjedhës dalëse shtesë.</p> <p>Rrjedha dalëse shtesë që korrespondon me nevojat e kolateralit që rezultojnë nga impakti i skenarit negativ të tregut në transaksionet</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>derivative të bankës që konsiderohen materiale, do të jetë neto rrjedha dalëse absolute më e madhe 30 ditore e kolateralit e realizur gjatë 24 muajve që i paraprinë datës së llogaritjes së kërkesës së mbulimit me likuiditet.</p> <p>Bankat mund të trajtojnë vetëm rrjedhat hyrëse dhe rrjedhat dalëse të transaksioneve në baza neto ku ato janë ekzekutuar sipas marrëveshjes master të netimit të njëjtë. Rrjedha absolute e neto kolateralit do të bazohet në rrjedhat dalëse dhe hyrëse të realizuara, dhe netimi do të llogaritet në nivel të portfolios së bankës.</p> |
| 33 | <p>1.1.5.4. rrjedhat dalëse nga derivativët</p> <p>Neni 23 paragrafi 6 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e rrjedhave dalëse të pritura gjatë 30 ditëve kalendarike nga kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe nga derivativët kreditor të llogaritur në pajtueshmëri me nenin 16.</p> <p>Për rastet e raportimit vetëm në valutë të huaj, bankat do të raportojnë rrjedhat dalëse që ndodhin vetëm në valutën e rëndësishme përkatëse. Netimi nga kundërpala mund vetëm të zbatohet për rrjedhat në atë valutë, për shembull Kundërpala A: Euro +10 dhe Kundërpala A: Euro -20 do të raportohet si rrjedhë dalëse Euro 10. Nuk lejohet asnjë netim në mesin e kundërpalëve, për shembull Kundërpala A: Euro -10, Kundërpala B: Euro +40 do të raportohet si rrjedhë dalëse Euro 10 në formularin mbi Rrjedhat Dalëse dhe rrjedhë hyrëse Euro 40 në formularin mbi Rrjedhat Hyrëse.</p> |
| 34 | <p>1.1.5.5. pozicionet e shkurta</p> <p>Neni 23 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Në rastet kur banka ka një pozicion të shkurtë që është i mbuluar nga dhënia hua e pasiguruar e një letre me vlerë, banka do të shtojë një rrjedhë dalëse shtesë që korrespondon me 100% të vlerës së tregut të letrave me vlerë ose të asetëve tjera të shitura në pozicion të shkurtë përveç nëse kushtet sipas të cilave banka i ka huazuar ato kërkojnë kthimin e tyre vetëm pas 30 ditëve kalendarike. Në rastet kur pozicioni i shkurtë është i mbuluar me transaksione të financimit të letrave me vlerë të kolateralizuara, banka do të supozojë që pozicioni i shkurtë do të mbahet përgjatë periudhës së 30 ditëve kalendarike dhe do të marrë normë të rrjedhës dalëse prej 0%.</p> |

| | |
|----|--|
| 35 | <p>1.1.5.5.1. të mbuluara me TFLV (transaksionet e financimit të letrave me vlerë) të kolateralizuara</p> <p>Neni 23 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të letrave me vlerë ose të aseteve tjera të shitura në pozicione të shkurta që janë të mbuluara nga transaksionet e financimit të letrave me vlerë të kolateralizuara dhe që duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve kalendarike përveç nëse banka i ka huazuar këto letra me vlerë me kushte që kërkojnë kthimin e tyre vetëm pas periudhës së 30 ditëve kalendarike.</p> |
| 36 | <p>1.1.5.5.2. tjera</p> <p>Neni 23 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të letrave me vlerë ose të aseteve tjera të shitura në pozicione të shkurta që janë të ndryshme nga ato të mbuluara nga transaksionet e financimit të letrave me vlerë të kolateralizuara dhe që duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve kalendarike përveç nëse banka i ka huazuar këto letra me vlerë me kushte që kërkojnë kthimin e tyre vetëm pas periudhës së 30 ditëve kalendarike</p> |
| 37 | <p>1.1.5.6. kolaterali shtesë i kërkueshëm</p> <p>Neni 23 paragrafi 8 nënparagrafi 8.1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të kolateralit shtesë që banka e mbanë dhe që në bazë të kontratës mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpala.</p> |
| 38 | <p>1.1.5.7. kolaterali për dorëzim/postim</p> <p>Neni 23 paragrafi 8 nënparagrafi 8.2 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të kolateralit që është për tu postuar/dorëzuar tek kundërpala brenda periudhës së 30 ditëve kalendarike.</p> |

| | |
|----|---|
| 39 | <p>1.1.5.8. kolaterali në formë të aseteve likuide i këmbeshëm për asete jo likuide</p> <p>Neni 23 paragrafi 8 nënparagrafi 8.3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të kolateralit që kualifikohet si asete likuide për qëllim të Kapitullit II që mund të zëvendësohet për asete që i korrespondojnë aseteve që nuk do të kualifikohen si asete likuide për qëllim të Kapitullit II pa pëlqimin e bankës.</p> |
| 40 | <p>1.1.5.9. netimi i brendshëm i pozicioneve të klientit</p> <p>Neni 23 paragrafi 10 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu vlerën e tregut të aseteve jolikuide të një klienti që në raport me shërbimet e brokerimit primar, banka i ka përdorur për të mbuluar shitjet në pozicion të shkurtë të një klienti tjetër duke i përputhur ato nga brenda.</p> |
| 41 | <p>1.1.6. lehtësirat e zotuar</p> <p>Neni 24 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi rrjedhat dalëse siç përcaktohet në Nenin 24. Shuma maksimale që mund të tërhiqet do të vlerësohet në pajtueshmëri me Nenin 24 paragrafi 2.</p> |
| 42 | <p>1.1.6.1. lehtësirat kreditore</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi lehtësirat kreditore të zotuar siç përkufizohet në Nenin 24 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |
| 43 | <p>1.1.6.1.1. ndaj klientëve me pakicë</p> <p>Neni 24 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqej nga lehtësirat kreditore të zotuar të patërhequra ndaj klientëve me pakicë siç përkufizohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |

| | |
|----|---|
| 44 | <p>1.1.6.1.2. ndaj klientëve jo financiar përveç klientëve me pakicë</p> <p>Neni 24 paragrafi 4 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqej nga lehtësirat kreditore të zotuar të patërhequra ndaj klientëve që as nuk janë klientë financiar as klientë me pakicë siç përkufizohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe të cilat nuk janë ofruar për qëllim të zëvendësimit të financimit të klientit në situatat ku klienti e ka të pamundur të marrë kërkesat e financimit në tregjet financiare.</p> |
| 45 | <p>1.1.6.1.3. ndaj institucioneve kredidhënëse</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi lehtësirat kreditore të zotuar të dhëna ndaj institucioneve kredidhënëse.</p> |
| 46 | <p>1.1.6.1.3.1. të tjera</p> <p>Neni 24 paragrafi 6, nënparagrafi 6.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat kreditore të zotuar të patërhequra të dhëna ndaj insitucioneve kredidhënëse përveç atyre të raportuara më lartë.</p> |
| 47 | <p>1.1.6.1.4. ndaj institucioneve financiare të rregulluara përveç institucioneve kredidhënëse</p> <p>Neni 24 paragrafi 6, nënparagrafi 6.1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat kreditore të zotuar të patërhequra të dhëna ndaj institucioneve financiare të rregulluara përveç institucioneve kredidhënëse.</p> |
| 48 | <p>1.1.6.1.5. ndaj klientëve tjerë financiar</p> <p>Neni 24 paragrafi 6, nënparagrafi 6.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat kreditore të zotuar të patërhequra përveç atyre të raportuara më lartë ndaj klientëve tjerë financiar.</p> |

| | |
|----|--|
| 49 | <p>1.1.6.2. lehtësirat e likuiditetit</p> <p>Neni 24 paragrafi 1 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi lehtësirat e likuiditetit të zotuarra siç përcaktohet në Nenin 24 paragrafi 1.</p> |
| 50 | <p>1.1.6.2.1. ndaj klientëve me pakicë</p> <p>Neni 24 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuarra të patërhequra ndaj klientëve me pakicë siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 51 | <p>1.1.6.2.2. ndaj klientëve jo-financiar përveç klientëve me pakicë</p> <p>Neni 24 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuarra të patërhequra ndaj klientëve që nuk janë as klientë financiar as klientë me pakicë në pajtueshmëri me Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 52 | <p>1.1.6.2.3. ndaj shoqërive investuese personale</p> <p>Neni 24 paragrafi 5 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuarra të patërhequra të dhëna ndaj shoqërive investuese private.</p> |
| 53 | <p>1.1.6.2.4. ndaj institucioneve kredidhënëse</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi lehtësirat e likuiditetit të patërhequra të dhëna ndaj institucioneve kredidhënëse.</p> |

| | |
|----|---|
| 54 | <p>1.1.6.2.4.1. tjera</p> <p>Neni 24 paragrafi 6, nënparagrafi 6.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuar të patërhequra të dhëna ndaj institucionet kredidhënëse që nuk janë përmendur më lartë.</p> |
| 55 | <p>1.1.6.2.5. ndaj klientëve financiar tjerë</p> <p>Neni 24 paragrafi 6, nënparagrafi 6.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuar të patërhequra të ndryshme nga ato të raportuara më lartë ndaj klientëve financiar tjerë.</p> |
| 56 | <p>1.1.7. Produktet dhe shërbimet tjera</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu mbi produktet ose shërbimet e përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 1. Shuma që duhet raportuar do të jetë shuma maksimale që mund të tërhiqet nga këto produkte ose shërbime të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 1. Pesha e zbatuar që duhet raportuar do të jetë pesha siç përcaktohet nga BQK në pajtueshmëri me Nenin 18 paragrafi 3.</p> |
| 57 | <p>1.1.7.1. Lehtësirat e financimit të pazotuar</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e lehtësirave të financimit të pazotuar të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 1. Garancitë nuk do të raportohen në këtë rresht.</p> |
| 58 | <p>1.1.7.2. kreditë dhe avanset e patërhequra ndaj kundërpalëve jo me pakicë</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë shumën e kredive dhe avanseve të patërhequra ndaj kundërpalëve jo me pakicë të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 1.</p> |
| 59 | <p>1.1.7.3. kreditë e mbuluara me hipotekë të nënshkruara por të patërhequra</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e kredive të mbuluara me hipotekë të nënshkruara por të patërhequra të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2.</p> |
| 60 | <p>1.1.7.4. kartelat kreditore</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e kartelave kreditore të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2.</p> |
| 61 | <p>1.1.7.5. mbitërheqjet</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e mbitërheqjeve të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2</p> |
| 62 | <p>1.1.7.6. rrjedhat dalëse të planifikuara që lidhen me rinovimin ose zgjatjen e afatit për kreditë e reja ndaj klientëve me pakicë ose jo me pakicë</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e rrjedhave dalëse të planifikuara që lidhen me rinovimin ose zgjatjen e afatit për kreditë e reja ndaj klientëve me pakicë ose jo me pakicë të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2.</p> |
| 63 | <p>1.1.7.7. Derivatvët e pagueshëm</p> <p>Neni 18 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të raportojnë shumën e derivativëve të pagueshëm, përveç kontratave të listuara në Aneksin IV të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe derivativët kreditor të përcaktuar në Nenin 18 paragrafi 2.</p> |
| 64 | <p>1.1.7.8. produktet jashtëbilancore të lidhura me financimin tregtar</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e produkteve ose shërbimeve të lidhura me produktet jashtëbilancore të lidhura me financimin tregtar të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2.</p> |
| 65 | <p>1.1.7.9. tjera</p> <p>Neni 18 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e produkteve ose shërbimeve tjera përveç atyre të përmendura më lartë të përcaktuara në Nenin 18 paragrafi 2. Garancitë, në mesin e zërave tjerë, do të raportohen në këtë rresht. Rrjedhat dalëse kontingjente për shkak të nxitjeve përveç nxitjeve nga zvogëlimi i rejtingut përcaktuar në Nenin 23 paragrafi 2 dhe 4 do të raportohen në këtë rresht.</p> |
| 66 | <p>1.1.8. Detyrimet tjera dhe zotimet që duhet përmbushur</p> <p>Neni 22 paragrafi 3, Neni 22 paragrafi 6 dhe Neni 24 paragrafi 7 dhe 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë rrjedhat dalëse nga detyrimet tjera dhe zotimet që duhet përmbushur siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 2, Neni 22 paragrafi 6 dhe Neni 24 paragrafi 7 dhe 8. Ky zë gjithashtu do të përfshijë, ku është e nevojshme bilancet shtesë sipas Nenit 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3.</p> |
| 67 | <p>1.1.8.1. detyrimet që rrjedhin nga shpenzimet operative</p> <p>Neni 22 paragrafi 3 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të detyrimeve që rrjedhin nga shpenzimet operative të vetë bankës siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 3.</p> |

| | |
|----|--|
| 68 | <p>1.1.8.2. në formë të letrave me vlerë të borxhit nëse nuk trajtohet si depozitë me pakicë</p> <p>Neni 22 paragrafi 6 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të vlerënotave, obligacioneve dhe letrave të borxhit tjera, të emetuara nga banka përveç atyre të raportuara si depozita me pakicë siç përcaktohet në Nenin 22 paragrafi 6. Kjo shumë përfshinë gjithashtu kuponët që arrijnë për pagesë në 30 ditët e ardhshme kalendarike që i referohet të gjitha këtyre letrave me vlerë.</p> |
| 69 | <p>1.1.8.3 Teprica e financimit ndaj klientëve jofinanciar</p> <p>Neni 24 paragrafi 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ndryshimin ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj klientëve jofinanciar dhe shumës së rrjedhave hyrëse nga klientë të tillë të përcaktuar në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. atëherë kur ndryshimi ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim tejkalon shumën e rrjedhave hyrëse.</p> |
| 70 | <p>1.1.8.3.1 teprica e financimit ndaj klientëve me pakicë</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ndryshimin ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj klientëve me pakicë dhe shumës së rrjedhave hyrëse nga klientë të tillë të përcaktuar në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. atëherë kur ndryshimi ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim tejkalon shumën e rrjedhave hyrëse.</p> |
| 71 | <p>1.1.8.3.2 teprica e financimit ndaj korporatave jofinanciare</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ndryshimin ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj klientëve të korporatave jofinanciare dhe shumës së rrjedhave hyrëse nga klientë të tillë të përcaktuar në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. atëherë kur ndryshimi ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim tejkalon shumën e rrjedhave hyrëse.</p> |

| | |
|----|---|
| 72 | <p>1.1.8.3.3 teprica e financimit ndaj Qeverive Qendrore, Bankave mulatilaterale zhvillimore dhe entiteteve të sektorit publik</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ndryshimin ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj Qeverive Qendrore, Bankave shumëpalëshe të zhvillimit dhe entiteteve të sektorit publik dhe shumës së rrjedhave hyrëse nga klientë të tillë të përcaktuar në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. atëherë kur ndryshimi ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim tejkalon shumën e rrjedhave hyrëse.</p> |
| 73 | <p>1.1.8.3.4 teprica e financimit ndaj entiteteve ligjore tjera</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu ndryshimin ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj entiteteve tjera ligjore dhe shumës së rrjedhave hyrëse nga klientë të tillë të përcaktuar në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1. atëherë kur ndryshimi ndërmjet zotimeve kontraktuale për të lejuar financim tejkalon shumën e rrjedhave hyrëse.</p> |
| 74 | <p>1.1.8.4 Asetet e huazuara pa garanci</p> <p>Neni 22 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu asetet e huazuara pa dhënë ndonjë garanci dhe që maturojnë brenda 30 ditëve. Këto asete do të supozohen se do të tërhiqen plotësisht deri në 100% të rrjedhës dalëse. Bankat do të raportojnë vlerën e tregut të aseteve të huazuara pa dhënë ndonjë garanci dhe që maturojnë brenda periudhës 30 ditore për rastet ku banka nuk i zotëron letrat me vlerë dhe të cilat nuk janë pjesë e rezervës së likuiditetit të bankës.</p> |
| 75 | <p>1.1.8.5 tjerat</p> <p>Neni 24 paragrafi 7 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilancit të mbetur të çdo detyrimi që arrinë për shlyerje në 30 ditët kalendarike të ardhshme përveç atyre të përcaktuara në Nenin 19 deri në 24.</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Ky rresht do të përfshijë vetëm ndonjë rrjedhë dalëse shtesë nga transaksionet e pasiguruara. Transaksionet e siguruara do të raportohen sipas zërit 1.2. mbi “Rrjedhat dalëse nga kreditimi i siguarar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit” dhe sipas zërit 1.3. mbi “Gjithsej rrjedhat dalëse nga kundërkëmbimet e kolateralit”.</p> |
| 76 | <p>1.2. Rrjedhat dalëse nga kreditimi i siguarar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit</p> <p>Neni 22 paragrafi 4 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguarar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit. Transaksionet e kundërkëmbimit të kolateralit (që mbulojnë transaksionet kolateral kundrejt kolateralit) do të raportohen në formularin mbi Kundërkëmbimet e Kolateralit.</p> |
| 77 | <p>1.2.1. Kundërpala është bankë qendrore</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguarar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kundërpala është bankë qendrore.</p> |
| 78 | <p>1.2.1.1. kolaterali i nivelit 1</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguarar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 1, por për të qenë i përdorur si kolateral për ato qëllime, do të kualifikohej në pajtueshmëri me Nenin 7 dhe 10 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |
| 79 | <p>1.2.1.1.1 i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.1.1. ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |

| | |
|----|---|
| 80 | <p>1.2.1.2. kolaterali i nivelit 2A</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 2A dhe , për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 7 dhe 11 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |
| 81 | <p>1.2.1.2.1 i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.1.2. ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |
| 82 | <p>1.2.1.3. kolaterali tjetër i ase teve të Nivelit 2B</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.1. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 2B që nuk është marrë parasysh më lartë dhe, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 7 dhe 12 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |
| 83 | <p>1.2.1.3.1 i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.1.3. (më lartë) ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |

| | |
|----|---|
| 84 | <p>1.2.1.4. kolaterali në formë të asetëve jolikuide</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.1. i Rregullors për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i asetëve jolikuide.</p> |
| 85 | <p>1.2.2. Kundërpala nuk është bankë qendrore</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala nuk është bankë qendrore.</p> |
| 86 | <p>1.2.2.1. Kolaterali i Nivelit 1</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.1. i Rregullors për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 1, por për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 7 dhe 10 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid. |
| 87 | <p>1.2.2.1.1. i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.2.1. (më lartë) ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid. |

| | |
|----|--|
| 88 | <p>1.2.2.2. Kolaterali i Nivelit 2A</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.2. i Rregullors për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 2A, por për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 7 dhe 11 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |
| 89 | <p>1.2.2.2.1. i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.2.2. (më lartë) ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid. |
| 90 | <p>1.2.2.3. Kolaterali tjetër i aseteve të Nivelit 2B</p> <p>Neni 22 paragrafi 4, nënparagrafi 4.4. i Rregullors për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i Nivelit 2B që nuk është përcaktuar më lartë, por për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 7 dhe 12 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid. |
| 91 | <p>1.2.2.3.1. i cili kolateral i lejuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Kolaterali i transaksioneve në zërin 1.2.2.3. (më lartë) ku kolaterali, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikohej me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si aset likuid.</p> |

| | |
|----|--|
| 92 | <p>1.2.2.4. kolaterali në formë të aseteve jolikuide</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat dalëse që rrjedhin nga kreditimi i siguarur dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit siç përcaktohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet ku kundërpala është një bankë qendrore dhe kolaterali i lejuar është kolateral i aseteve jolikuide.</p> |
| 93 | <p>1.3. Gjithsej rrjedhat dalëse nga kundërkëmbimi i kolateralit</p> <p>Shuma e rrjedhave dalëse nga kolona 7 e Formularit mbi Kundërkëmbimet e Kolateralit do të raportohet në kolonën 6.</p> |
| | <p>ZËRA MEMORANDUMI</p> |
| 94 | <p>2. Depozitat operacionale të mbajtua për kliring, kujdestari, menaxhim të parasë së gatshme ose shërbime të krahasueshme në kontekst të marrëdhënies operacionale të krijuar</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu depozitat operacionale të përcaktuara në zërin 1.1.2.1, të ndara sipas kundërpalëve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> — bankat — klientët financiar përveç bankave; — qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik; — klientë të tjerë. |
| 95 | <p>2.1. të ofruara nga institucionet kredidhënëse</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilanceve të mbetura nga depozitat operacionale të përcaktuara në zërin 1.1.2.1. të ofruara nga institucionet kredidhënëse</p> |
| 96 | <p>2.2. të ofruara nga klientët financiar përveç institucioneve kredidhënëse</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilanceve të mbetura të depozitave operacionale të përcaktuara në zërin 1.1.2.1. të ofruara nga klientët financiar përveç institucioneve kredidhënëse.</p> |
| 97 | <p>2.3. të ofruara nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilanceve të mbetura të depozitave operacionale të përcaktuara në zërin 1.1.2.1. të ofruara nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik.</p> |
| 98 | <p>2.4. të ofruara nga klientë tjerë</p> <p>Bankat do të raportojnë shumën e bilanceve të mbetura të depozitave operacionale të përcaktuara në zërin 1.1.2.1. të ofruara nga klientë tjerë (përveç atyre të përmendur më lartë dhe klientëve që konsiderohen për depozita me pakicë).</p> |
| 99 | <p>3. Rrjedhat dalëse të këmbimit valutor</p> <p>Ky zë do të raportohet vetëm në rast të raportimit në valuta që janë subjekt i raportimit të ndarë.</p> <p>Përrastet e raportimit në një valutë të ndarë, bankat do të raportojnë vetëm pjesën e rrjedhave dalëse nga derivativët (të raportuar në zërin 1.1.5.4.) që lidhen me rrjedhat e principalit të këmbimit valuator në valutën e rëndësishme përkatëse nga kundërkëmbimet e valutave të kryqëzuara, këmbimit valutor aktual (ang. spot) dhe transaksionet në të ardhmen që maturojnë brenda periudhës 30 ditore. Netimi nga kundërpala mund të aplikohet vetëm ndaj rrjedhave në atë valutë, për shembull Kundërpala A: Euro +10 dhe Kundërpala A: Euro -20 do të raportohen si Euro 10 rrjedhë dalëse. Nuk duhet të bëhet asnjë netim në mesin e kundërpalëve, për shembull Kundërpala A: Euro -10, Kundërpala B: Euro +40 do të raportohen si Euro 10 rrjedhë dalëse në Formularin mbi Rrjedhat Dalëse (dhe Euro 40 rrjedhë hyrëse në Formularin mbi Rrjedhat Hyrëse).</p> |

PJESA 3

RRJEDHAT HYRËSE

1. Udhëzime të përgjithshme

- 1.1. Formulari mbi rrjedhat hyrëse përmban informacion rreth rrjedhave hyrëse të likuiditetit të matura përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike, për qëllim të raportimit të kërkesës së mbulimit me likuiditet siç përcaktohet në Rregulloren

për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Zërat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë të hijezuara me ngjyrë të hirtë.

- 1.2. Bankat do të raportojnë formularin në Euro. Banka do të raportojë ndaras formularin nëse detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës.
- 1.3. Në pajtueshmëri me Nenin 25 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, rrjedhat hyrëse të likuiditetit do të:
 - 1.3.1. përfshijnë vetëm rrjedhat hyrëse të kontraktuara nga ekspozimet që nuk janë në vonesë dhe për të cilat banka nuk ka arsye të presë joperformancë brenda periudhës 30 ditore.
 - 1.3.2. llogariten duke shumëzuar bilancet e mbetura të kategorive të ndryshme të të arkëtueshmeve të kontraktuara me normat e përcaktuara në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.
- 1.4. Në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, bankat do të raportojnë rrjedhat hyrëse nga çdo aset likuid i raportuar në pajtueshmëri me Kapitullin II përveç pagesave për shlyerje në asetet që nuk janë pasqyruar në vlerën e tregut të asetit.
- 1.5. Rrjedhat hyrëse që pranohen në vende të huaja ku ekzistojnë kufizime të transfereve ose të që janë të denominuara në valuta jo të konvertueshme do të raportohen në rreshtat përkatës të seksioneve 1.1., 1.2., ose 1.3.. Rrjedhat hyrëse do të raportohen plotësisht, pavarësisht shumës së rrjedhave dalëse në vendin e huaj apo valutën e huaj.
- 1.6. Paratë e gatshme për tu arkëtuar nga letrat me vlerë të emetuara nga vetë banka ose nga një Entitet Sekjuritizimi për Qëllime të Veçanta (ESQV) me të cilin banka ka lidhje të afërta do të merren parasysh në baza neto me një normë të rrjedhës hyrëse të zbatuar në bazë të normës së rrjedhës hyrëse të zbatuar për asetet bazë sipas Nenit 25 paragrafi 3, nënparagrafi 3.8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.
- 1.7. Në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 7 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, bankat nuk do të raportojnë rrjedhat hyrëse nga ndonjë detyrim i ri i kontraktuar. Kjo i referohet zotimeve kontraktuale që nuk kanë qenë të kontraktuara në datën e raportimit, por që do të ose mund të kontraktohen brenda periudhës 30 ditore.
- 1.8. Në rast të një raportimi të ndarë nga banka në rastet kur detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga Euro që arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës, bilancet e raportuara do të përfshijnë vetëm ato që janë të

denominuara në valutën përkatëse për të siguruar që hendeqet valutore janë të pasqyruara në mënyrë korrekte. Kjo mund të nënkuptojë që vetëm njëra anë e transaksionit raportohet në formularin e valutës përkatëse. Për shembull, në rast të derivativëve të këmbimit valutor, bankat mund të netojnë rrjedhat hyrëse dhe dalëse vetëm në pajtim me Nenin 16 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet kur janë të denominuara në valutë të njëjtë.

- 1.9. Struktura e kolonës së kësaj forme është ndërtuar për të akomoduar limitet në rrjedhat hyrëse të zbatuara sipas Nenit 26 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.
 - 1.10. Në pajtueshmëri me Nenin 4 paragrafi 9, nënparagrafi 9.3. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet lidhur me konsolidimin, rrjedhat hyrëse të likuiditetit në një filialë në një vend të huaj që janë subjekt i ligjeve vendore të atij vendi të huaj i normave më të ulëta sesa ato të përcaktuara në Kapitullin III të rregullores do të jenë subjekt i konsolidimit në pajtueshmëri me normat më të ulëta të përcaktuara në ligjin vendor të vendit të huaj.
 - 1.11. Rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet i referohet vetëm normave dhe faktorëve zvogëlues (ang. haircuts) dhe fjala “peshë” vetëm se i referohet këtyre. Në këto udhëzime fjala “e peshuar” përdoret si term i përgjithshëm për të treguar shumën e fituar pas aplikimit të faktorëve zvogëlues të caktuar, normave dhe çdo udhëzimi tjetër shtesë me rëndësi (në rast të p.sh., kreditimit të siguruar dhe financimit).
 - 1.12. Disa “zëra memorandumi” janë përfshirë në formularët e shoqëruar në këto udhëzime. Në mesin e tjerëve këta zëra ofrojnë informacionin e nevojshëm për të lejuar BQK-në të kryejë një vlerësim adekuat të pajtueshmërisë së bankave me kërkesat e likuiditetit.
2. Udhëzime specifike lidhur me kreditimin e siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit
 - 2.1. Kategoritë e formularëve të rrjedhave të kolateralizuara nga kualiteti i asetit bazë ose pranueshmërisë së aseteve likuide me kualitet të lartë. Një formular i ndarë është ofruar për kundërkëmbimet e kolateralit. Kundërkëmbimet e kolateralit, që janë transaksione kolateral-kundrejt-kolateralit nuk do të raportohen në formularin mbi Rrjedhat Hyrëse i cili i referohet vetëm transaksioneve të parasë së gatshme kundrejt kolateralit.
 - 2.2. Në rast të një raportimi të ndarë nga banka në rastet kur detyrimet agregate në një valutë të ndryshme nga Euro që arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës, bilancet e raportuara do të përfshijnë vetëm ato që janë të denominuara në valutën përkatëse për të siguruar që hendeqet valutore janë të

pasqyruara në mënyrë korrekte. Kjo mund të nënkuptojë që vetëm njëra anë e transaksionit raportohet në formularin e valutës përkatëse. Kështu që një transaksion i marrëveshjes riblerëse të ndërsjelltë mund të rezultojë në rrjedhë hyrëse negative. Transaksionet e marrëveshjes riblerëse të ndërsjelltë të raportuar në të njëjtin zë do të mbliidhen (pozitive dhe negative). Nëse gjithsej totali është pozitiv pastaj do të raportohet në formularin mbi Rrjedhat Hyrëse. Nëse totali është negative pastaj do të raportohet në formularin mbi Rrjedhat Dalëse. Kjo qasje do të zbatohet anasjelltas për marrëveshjet riblerëse.

2.3. Për llogaritjen e rrjedhave hyrëse, kreditimi i siguruar dhe trasaksionet e bazuara në tregun e kapitalit do të raportohen pavarësisht nëse kolaterali bazë i pranuar i plotëson kërkesat operacionale siç përcaktohet në Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Gjithashtu, në mënyrë që të lejohet llogaritja e stokut të asteve likuide të rregulluara në pajtueshmëri me Nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, bankat gjithashtu do të raportojnë ndaras ato transaksione ku kolaterali bazë i pranuar i plotëson edhe kërkesat operacionale siç përcaktohet me Nenin 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.

2.4. Në rastet kur banka mund të njohë vetëm pjesën e aksioneve të valutës së huaj të tyre, ose asetet e qeverisë qendrore ose të bankës qendrore në valutë të huaj, ose asetet e qeverisë qendrore ose të bankës qendrore në valutë vendore në kuadër të Aseteve likuide me kualitet të lartë, vetëm pjesa e njohur (e pranuar) do të raportohet në kuadër të rreshtave të lidhur me Nivelin 1, Nivelin 2A dhe Nivelin 2B (të përcaktuar në Nenin 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet). Në rastin kur një aset i caktuar përdoret si kolateral por për një shumë që është tepriçë për pjesën e cila mund të njihet si aset likuid, shumta e tepriçës do të raportohet në pjesën jolikuide. Asetet e Nivelit 2A do të raportohen në rreshtin përkatës të asetit të Nivelit 2A.

3. Udhëzimet specifike lidhur me shlyerjet dhe transaksionet filluese në të ardhmen

3.1. Bankat do të raportojnë rrjedhat hyrëse që rrjedhin nga marrëveshjet riblerëse që fillojnë në të ardhmen e që fillojnë brenda periudhës 30 ditore dhe maturojnë përtej periudhës 30 ditore. Rrjedha hyrëse që duhet të pranohet do të raportohet në {F3; rr23} ('rrjedhat hyrëse tjera'), neto nga vlera e tregut të asetit që duhet të dorëzohet tek kundërpala pas zbatimit të faktorit zvogëlues të TML. Nëse aset i nuk është "aset likuid" rrjedha hyrëse që duhet të pranohet do të raportohet plotësisht. Aseti që do të lihet peng si kolateral do të raportohet në Formularin mbi Asetet Likuide nëse banka e mbanë asetin në librat e saj në datën referente dhe që i plotëson kushtet e lidhura. Marrëveshjet riblerëse me pajtim paraprak, marrëveshjet riblerëse me pajtim paraprak të ndërsjellta dhe kundërkëmbimet e kolateralit me pajtim paraprak që fillojnë dhe maturojnë brenda periudhës 30

ditore të TML nuk kanë ndonjë ndikim në TML të bankës dhe mund të mos merren parasysh.

4. Rrjedhat hyrëse

4.1.Udhëzimet lidhur me kolonat specifike

| Kolona | Referencat ligjore dhe udhëzimet |
|--------|--|
| 1 | <p>Shuma – subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Për rreshtat {4},{6}-{9},{12}-{13},{15}-{23},{27}-{33},{35}-{36},{39-45}, {47}-{49} dhe {52}, bankat do të raportojnë në Kolonën 1 gjithsej shumën e asetëve/parave për tu arkëtuar/shumave maksimale që mund të tërhiqen që janë subjekt i limitit prej 75% të rrjedhave hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe udhëzimet përkatëse në vijim të përfshira këtu.</p> |
| 2 | <p>Vlera e tregut të kolateralit të pranuar – subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Për rreshtat {27}-{32},{39-44}, bankat do të raportojnë në Kolonën 2 vlerën e tregut të kolateralit të pranuar nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit që janë subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 3 | <p>Pesha standarde Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Peshat standarde në Kolonën 3 janë ato të përcaktuara në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe janë të dhëna vetëm për qëllim të informimit.</p> |
| 4 | <p>Pesha e zbatuar – subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Pesha e zbatuar janë ato pesha të përcaktuara në Nenet 25 dhe 26 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Peshat e zbatuara mund të rezultojnë në vlerat mesatare të peshuara dhe do të raportohen në terma decimal (d.m.th., 1.00 për një peshë të</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>aplikuar prej 100 përqind, ose 0.50 për një peshë të aplikuar prej 50 përqind). Peshat e zbatuara mund të pasqyrojnë por nuk janë të kufizuara në karakteristikat e bankës.</p> <p>Për rreshtat {4},{6}-{9},{12}-{13},{15}-{23},{27},{29},{31},{35}-{36},{39},{41}, {43},{47}-{49},{52}, bankat do të raportojnë në Kolonën 4 peshën mesatare të zbatuar ndaj asetëve/ parave të gatshme për tu arkëtuar/ shumave maksimale që mund të tërhiqen që janë subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 5 | <p>Vlera e kolateralit të pranuar sipas Nenit 9 – subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse</p> <p>Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Për rreshtat {28},{30},{32},{40},{42}, dhe {44}, bankat do të raportojnë në kolonën 5 vlerën e kolateralit të pranuar në pajtueshmëri me Nenin 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet në kreditimin e siguruar dhe transaksionet e kapitalit të drejtuara nga tregu që janë subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 6 | <p>Rrjedha hyrëse – subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse</p> <p>Neni 25 dhe Neni 26 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Për rreshtat {4},{6}-{9},{12}-{13},{15}-{23},{27},{29},{31},{35}-{36},{39},{41},{43},{52}, bankat do të raportojnë në Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse që janë subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet që do të llogaritet duke shumëzuar gjithsej shumën/shumën maksimale që mund të tërhiqet nga Kolona 010 me peshën përkatëse nga Kolona 4. Për rreshtin {170}, bankat do të raportojnë në Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse që janë subjekt i limitit prej 75% në rrjedhat hyrëse siç përcaktohet në Nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet vetëm nëse bankat kanë pranuar një zotim nga një bankë shumëpalëshe e zhvillimit ose nga një entitet i sektorit publik.</p> |

4.2.Udhëzimet lidhur me rreshtat specifik

| Rreshti | Korniza ligjore dhe udhëzimet |
|---------|--|
| 1 | <p>1. GJITHSEJ RRJEDHAT HYRËSE Neni 25 dhe Neni 26</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 1 të Formularit mbi Rrjedhat Hyrëse për kolonën 1 gjithsej shumën e asetëve/parave të gatshme për arkëtim/shumën maksimale që mund të tërhiqet sis humë e asetëve/ parave të gatshme për arkëtim/shumë maksimale që mund të tërhiqet nga transaksionet e pasiguruara/ depozitave dhe kreditimi i siguruar dhe transaksione të bazuara në tregun e kapitalit.</p> <p>për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse si shumë e rrjedhave hyrëse nga transaksionet e pasiguruara/depozitat, kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit dhe transaksionet e kundërkëmbimit të kolateralit duke zbritur ndryshimin ndërmjet gjithsej rrjedhave hyrëse të peshuara dhe gjithsej rrjedhat dalëse të peshuara që rrjedhin nga transaksionet në vendet e huaja ku ekzistojnë kufizime të transfereve ose që janë të denominuara në valuta të pakonvertueshme;</p> |
| 2 | <p>1.1. Rrjedhat hyrëse nga transaksionet e pasiguruara/depozitave Neni 25 dhe 26</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 2 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për kolonën 1, gjithsej shuma e asetëve/parave të gatshme për tu arkëtuar/shumës maksimale që mund të tërhiqen nga transaksionet e pasiguruara/depozitave; dhe</p> <p>për kolonën 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga transaksionet e pasiguruara/depozitat.</p> |
| 3 | <p>1.1.1. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar (me përjashtim të bankave qendrore)</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 3 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar (me përjashtim të bankave qendrore) (paratë e gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar që nuk korrespondojnë me pagesat e kryegjësë/principalit si dhe çdo para të gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar) dhe</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>për Kolonën 6, gjithsej rrejdhat hyrëse nga klientët jo-financiar (me përjashtim të bankave qendrore) (rrjedhat hyrëse për tu marrë nga klientët jo-financiar që nuk korrespondojnë me pagesat e kryegjësë/principalit si dhe çdo rrjedhë hyrëse nga klientët jo-financiar)</p> <p>Klientët jofinanciar do të përfshijnë, por pa u kufizuar në personat fizikë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, korporatat, qeveritë, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik në pajtueshmëri me Nenin 24 paragrafi 7 dhe 8.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me një klient jo-financiar që janë të kolateralizuara nga asetet likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II, siç përkufizohet në Rregulloren për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet, do të raportohet në zërin 1.2. dhe nuk do të raportohet në zërin 1.1.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga transaksionet e tilla që janë të kolateralizuara nga letrat me vlerë të transferueshme që nuk kualifikohen si asete likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet do të raportohen në zërin 1.2. dhe nuk do të raportohen në zërin 1.1.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga transaksionet e tilla me klientët jo-financiar që janë të kolateralizuara me asete që nuk transferohen dhe që nuk kualifikohen si asete likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet do të raportohen në rreshtin përkatës të seksionit 1.1.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore do të raportohen në zërin 1.1.2. dhe nuk do të raportohen këtu.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga transaksionet e financimit tregtar me maturitet të mbetur jo më shumë se 30 ditë do të raportohen në zërin 1.1.3. dhe nuk do të raportohen këtu.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga letrat me vlerë që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike do të raportohen në zërin 1.1.4 dhe nuk do të raportohen këtu.</p> |
| 4 | <p>1.1.1.1. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët jofinanciar (me përjashtim të bankave qendrore) që nuk korrespondojnë me pagesën e principalit/kryegjësë</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar (me përjashtim të bankave qendrore) me maturitet të mbetur jo më shumë se 30 ditë që nuk korrespondon me pagesën e principalit.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Këto rrjedha hyrëse përfshijnë interesin dhe tarifatat/komisionet për tu marrë nga klientët jofinanciar (me përjashtim të bankave qendrore).</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore që nuk korrespondojnë me pagesën e principalit do të raportohen në zërin 1.1.2 dhe nuk do të raportohen këtu.</p> |
| 5 | <p>1.1.1.2. paratë tjera të gatshme për tu marrë nga klientët jofinanciar (me përjashtim të bankave qendrore)</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 5 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave tjera të gatshme për tu marrë nga klientët jo-financiar (përveç bankave qendrore) si shumë e parave për tu marrë nga klientët jofinanciar nga kundërpala dhe për kolonën 6, gjithsej të rrjedhat hyrëse tjera nga klientët jofinanciar (përveç bankave qendrore) si shumë e rrjedhave hyrëse tjera nga klientët jofinanciar nga kundërpalët.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët jofinanciar (përveç bankave qendrore) që nuk korrespondojnë me pagesën e principalit do të raportohen në zërin 1.1.1.1. dhe nuk duhet të raportohen këtu.</p> <p>Paratë tjera të gatshme nga bankat qendrore do të raportohen në zërin 1.1.2. dhe nuk duhet të raportohen këtu.</p> |
| 6 | <p>1.1.1.2.1. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët me pakicë</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët me pakicë me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë.</p> |
| 7 | <p>1.1.1.2.2. paratë e gatshme për tu marrë nga korporatat jofinanciare</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga korporatat jofinanciare me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë.</p> |
| 8 | <p>1.1.1.2.3. paratë e gatshme për tu marrë nga qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga qeveritë qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë.</p> |
| 9 | <p>1.1.1.2.4. paratë e gatshme për tu marrë nga entitetet ligjore tjera Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga entitetet ligjore tjera që nuk janë të përfshira më lartë me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë.</p> |
| 10 | <p>1.1.2. paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar</p> <p>Neni 25 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 10 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar (depozitat operacionale dhe jo operacionale) Për kolonën 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga bankat qendrore dhe klientët financiar (depozitat operacionale dhe jo operacionale).</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu paratë e gatshme për tu marrë me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë nga bankat qendrore dhe klientët financiar, që nuk janë në vonesë dhe për të cilët banka nuk ka arsye të presë joperformim brenda periudhës 30 ditore.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar që nuk korrespondojnë me pagesën e principalit do të raportohen në zërin përkatës.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga transaksionet e financimit tregtar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë do të raportohen në zërin 1.1.3. dhe nuk duhe të raportohen këtu. Paratë e gatshme për tu marrë nga letrat me vlerë që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike do të raportohen në zërin 1.1.4 dhe nuk do të raportohen këtu.</p> |
| 11 | <p>1.1.2.1. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar që klasifikohen si depozita operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 11 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse për kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga klientët financiar që klasifikohen si depozita operacionale (pa marrë parasysh nëse banka është në gjendje të</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese ose jo); dhe për kolonën 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga klientët financiar që klasifikohen si depozita operationale (pa marrë parasysh nëse banka është në gjendje të krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese ose jo).</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar në mënyrë që për banka të marrë shërbime të kliringut, kujdestarisë ose të menaxhimit të parasë së gatshme në pajtueshmëri me Nenin 21.</p> |
| 12 | <p>1.1.2.1.1. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar që klasifikohen si depozita operationale ku banka është në gjendje të krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë në mënyrë që banka të përfitojë shërbime të kliringut, kujdestarisë ose menaxhimit të parasë së gatshme në pajtueshmëri me Nenin 21 ku banka është në gjendje të krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese.</p> |
| 13 | <p>1.1.2.1.2. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar që klasifikohen si depozita operationale ku banka nuk është në gjendje të krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë në mënyrë që banka të përfitojë shërbime të kliringut, kujdestarisë ose menaxhimit të parasë së gatshme në pajtueshmëri me Nenin 21 ose në rastet kur banka nuk ka mundësi të krijojë një normë të rrjedhës hyrëse simetrike korresponduese. Për këta zëra do të aplikohet një normë e rrjedhës hyrëse prej 5%.</p> |
| 14 | <p>1.1.2.2. paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar që nuk klasifikohen si depozita operationale</p> <p>Neni 25 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 14 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar që nuk klasifikohen si depozita operationale dhe</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse nga bankat qendrore dhe klientët financiar që nuk klasifikohen si depozita operationale.</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar që nuk kualifikohen për trajtimin si depozita operationale siç përcaktohet në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21.</p> |
| 15 | <p>1.1.2.2.1. paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore</p> <p>Neni 25 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga bankat qendrore me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafin 2, nënparagrafin 2.1.</p> |
| 16 | <p>1.1.2.2.2. paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar</p> <p>Neni 25 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga klientët financiar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë që nuk kualifikohen për trajtimin si depozita operationale siç përcaktohet në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4. në kombinim me Nenin 21.</p> |
| 17 | <p>1.1.3. paratë e gatshme për tu marrë nga letrat me vlerë që maturojnë brenda 30 ditëve</p> <p>Neni 25 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga letrat me vlerë që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2.</p> |
| 18 | <p>1.1.4. kreditë me datë kontraktuale të përfundimit të papërcaktuar</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.9.</p> <p>Kreditë me datë kontraktuale të përfundimit të papërcaktuar në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.9.</p> <p>Banka do të marrë parasysh vetëm ato kredi ku kontrata lejon bankën të tërheqë ose të kërkojë pagesën brenda 30 ditëve kalendarike. Interesi dhe pagesat minimale që do të debitohen kundrejt llogarisë së klientit brenda 30 ditëve kalendarike do të përfshihen në shumën e raportuar. Interesi dhe pagesat minimale nga kreditë me datë kontraktuale të përfundimit të papërcaktuar që janë sipas kontratës për pagesë që krijojnë një rrjedhë hyrëse në para të gatshme brenda 30 ditëve kalendarike do të konsiderohen si para për tu marrë dhe do të raportohen në rreshtin përkatës, duke</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>ndjekur trajtimin e përcaktuar me Nenin 25 për paratë e gatshme për tu marrë.</p> <p>Bankat nuk do të raportojnë interesin tjetër që do të përlllogaritet, por që nuk është debituar kundrejt llogarisë së klientit por as nuk krijon një rrjedhë hyrëse në para të gatshme përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike.</p> |
| 19 | <p>1.1.5. paratë e gatshme për tu marrë nga indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit me kusht që nuk ekziston dyfishim i llogaritjes me asetet likuide</p> <p>Neni 25 paragrafi 2, nënparagrafi 2.3.</p> <p>Paratë e gatshme për tu marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit me kusht që nuk ekziston dyfishim i llogaritjes me asetet likuide në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 2, nënparagrafi 2.3. të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet. Pozicionet do të përfshijnë paratë e gatshme që maturojnë sipas kontratës brenda 30 ditëve kalendarike, të tilla si dividendat në para të gatshme nga indekset kryesore dhe paratë e gatshme për tu marrë nga instrumentet e kapitalit të shitura por të pa shlyera, nëse nuk janë njohur si asete likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 20 | <p>1.1.6. rrjedhat hyrëse nga lejimi i bilanceve të mbajtura në llogaritë e ndara (ang. segregated accounts) në pajtueshmëri me kërkesat rregullative për mbrojtjen e aseteve të tregtimit nga klientët</p> <p>Neni 25 paragrafi 4</p> <p>Rrjedhat hyrëse nga lejimi i bilanceve të mbajtura në llogari të veçanta (ang. segregated accounts) në pajtueshmëri me kërkesat rregullative për mbrojtjen e aseteve të tregtimit nga klientët në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 4.</p> <p>Rrjedhat hyrëse do të konsiderohen nëse këto balance mbahen në asete likuide siç përcaktohet në Kapitullin II të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 21 | <p>1.1.7. rrjedhat hyrëse nga derivativët</p> <p>Neni 25 paragrafi 5 në kombinim me Nenin 16</p> <p>Shuma neto e të arkëtueshmeve që pritet të realizohen brenda periudhës së 30 ditëve kalendarike nga kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Bankat do të llogarisin rrjedhat hyrëse që pritet të ndodhin gjatë 30 ditëve kalendarike në baza neto nga kundërpalët që janë subjekt i ekzistimit të marrëveshjeve të netimit bilateral. Baza neto do të nënkuptojë gjithashtu neto nga kolaterali i pranuar me kusht që kualifikohet si aset likuid sipas Kapitullit II të Rregullores për Treguesit e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Rrjedhat dalëse dhe hyrëse në para të gatshme që ndodhin nga derivativët në valutë të huaj ose transaksionet e derivativëve kreditor që përfshijnë këmbimin e plotë të principalit/kryegjësë në baza të përnjëhershme (ose brenda të njëjtës ditë) do të llogaritet në baza neto, edhe në rastet kur këto transaksione nuk janë të mbuluara nga një marrëveshje e netimit bilateral.</p> <p>Në rastet e raportimit të ndarë nga banka në rastet kur detyrimet aggregate në një valutë të ndryshme nga euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës, derivativit ose transaksioneve të derivativëve kreditor do të ndahen në secilën valutë përkatëse. Netimi sipas kundërpalëve mund vetëm të aplikohet për rrjedhat në atë valutë.</p> |
| 22 | <p>1.1.8. rrjedhat hyrëse tjera</p> <p>Neni 25 paragrafi 2</p> <p>Të gjitha rrjedhat hyrëse tjera në pajtueshmëri me Nenin 25 paragrafi 2 që nuk janë raportuar diku tjetër në formular.</p> |
| 23 | <p>1.2. Rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2., Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3. dhe Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.6. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet i referohet rrjedhave hyrëse që rezultojnë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 24 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit; dhe</p> <p>për Kolonën 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit.</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Transaksionet e kundërkëmbimit të kolateralit që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike do të raportohen në formularin mbi Kundërkëmbimet e Kolateralit dhe nuk do të raportohen këtu.</p> |
| 24 | <p>1.2.1. kundërpala është bankë qendrore</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat hyrëse që rezultojnë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 25 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kundërpala është bankë qendrore; dhe</p> <p>për çdo Kolonë 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kundërpala është bankë qendrore.</p> |
| 25 | <p>1.2.1.1. kolaterali që kualifikohet si aset likuid</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 26 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <ul style="list-style-type: none"> - për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete likuide; dhe - për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet likuide. <p>Bankat do të raportojnë transaksionet nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet likuide, pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër dhe pavarësisht nëse asetet likuide të pranuarra i plotësojnë kërkesat operationale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |

| | |
|----|--|
| 26 | <p>1.2.1.1.1. Kolaterali i Nivelit 1</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenet 7 dhe 10 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 1 të përcaktuar në Nenin 10.</p> |
| 27 | <p>1.2.1.1.1.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.1.1.1., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 28 | <p>1.2.1.1.2. Kolaterali i Nivelit 2A</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenet 7 dhe 11 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 2A të përcaktuara në Nenin 11.</p> |
| 29 | <p>1.2.1.1.2.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.1.1.3., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |

| | |
|----|---|
| 30 | <p>1.2.1.1.3. Kolaterali i Nivelit 2B</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenet 7 dhe 12 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 2B të përcaktuara në Nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2.</p> |
| 31 | <p>1.2.1.1.3.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.1.1.7., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 32 | <p>1.2.1.2. kolaterali është përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet që janë përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë në pajtueshmëri me fjalinë e dytë të Nenit 23 paragrafi 7. Në rastet kur kolaterali i çdo lloji është përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë, do të raportohet këtu dhe jo në ndonjë nga rreshtat më lartë. Nuk duhet të ketë numërim të dyfishtë.</p> |
| 33 | <p>1.2.1.3. kolaterali që nuk kualifikohet si aset likuid</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 34 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse kreditimin e siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku kolaterali nuk kualifikohet si aset likuid. Bankat do të raportojnë</p> |

| | |
|----|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga ato transaksione si shumë e parave për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kolaterali është capital jo likuid dhe kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit të mbuluara nga ndonjë kolateral jolikuid tjetër; - për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse nga ato transaksione si shumë e rrjedhave hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kolaterali është kapital jolikuid dhe kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit të mbuluara nga ndonjë kolateral jolikuid tjetër. |
| 34 | <p>1.2.1.3.1. kolaterali është kapital jo likuid</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 në nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është kapital jolikuid i kolateralizuar.</p> |
| 35 | <p>1.2.1.3.2 gjithë kolaterali tjetër jolikuid</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete jo likuide që nuk janë të përfshira në zërin 1.2.1.3.1.</p> |
| 36 | <p>1.2.2. kundërpala nuk është bankë qendrore</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu rrjedhat hyrëse që rezultojnë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë dhe ku kundërpala nuk është bankë qendrore.</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 37 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <p>për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kundërpala nuk është bankë qendrore; dhe</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kundërpala nuk është bankë qendrore.</p> |
| 37 | <p>1.2.2.1. kolaterali që kualifikohet si aset likuid</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 38 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse</p> <ul style="list-style-type: none"> - për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete likuide; - për Kolonën 6 gjithsej rrjedhat hyrëse nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete likuide. <p>Bankat do të raportojnë kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete likuide, pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër dhe pavarësisht nëse asetet likuide të marra i plotësojnë kërkesat operationale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 38 | <p>1.2.2.1.1. Kolaterali i Nivelit 1</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenin 7 dhe 10 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 1 të përcaktuara në Nenin 10.</p> |
| 39 | <p>1.2.2.1.1.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operationale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|--|
| | <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.2.1.1., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |
| 40 | <p>1.2.2.1.2. Kolaterali i Nivelit 2A</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenin 7 dhe 11 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 2A të përcaktuara në Nenin 11.</p> |
| 41 | <p>1.2.2.1.2.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.2.1.3., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 42 | <p>1.2.2.1.3. Kolaterali i nivelit 2B</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar me asete që pavarësisht nëse janë përdorur në ndonjë transaksion tjetër, do të kualifikohen në pajtueshmëri me Nenin 7 dhe 12 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet si asete likuide të ndonjërës nga kategoritë e aseteve të Nivelit 2B të përcaktuara në Nenin 12, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2.</p> |
| 43 | <p>1.2.2.1.3.1. prej të cilit kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> |

| | |
|----|---|
| | <p>Prej transaksioneve në zërin 1.2.2.1.7., ato transaksione ku kolaterali i pranuar i plotëson kërkesat operacionale sipas Nenit 8 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |
| 44 | <p>1.2.2.2. kolaterali është përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asetet që janë përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë në pajtueshmëri me fjalinë e dytë të Nenit 23 paragrafi 7. Në rastet kur kolaterali i çdo lloji është përdorur për të mbuluar një pozicion të shkurtë, do të raportohet këtu dhe jo në ndonjë nga rreshtat më lartë. Nuk duhet të ketë numërim të dyfishtë.</p> |
| 45 | <p>1.2.2.3. kolaterali që nuk kualifikohet si aset likuid</p> <p>Bankat do të raportojnë në rreshtin 46 të formularit mbi Rrjedhat Hyrëse Kreditimin e siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku kolaterali nuk kualifikohet si aset likuid.</p> <p>Bankat do të raportojnë për Kolonën 1, gjithsej shumën e parave të gatshme për tu marrë nga ato transaksione si shumë e parave të gatshme për tu marrë nga kreditë margjinale ku kolaterali është jolikuid, kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kolaterali është kapital jolikuid dhe kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit të mbuluara nga ndonjë kolateral tjetër jolikuid; dhe</p> <p>për Kolonën 6, gjithsej rrjedhat hyrëse nga ato transaksione ku shuma e rrjedhave hyrëse nga kreditë margjinale ku kolaterali është jolikuid, kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit ku kolaterali është kapital jolikuid dhe kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit të mbuluara nga ndonjë kolateral tjetër jolikuid.</p> |
| 46 | <p>1.2.2.3.1. kreditë margjinale: kolaterali është jolikuid</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditë margjinale të realizuara kundrejt aseteve jolikuide me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku asetet e pranuar nuk janë përdorur për të mbuluar pozicione të shkurta siç përkufizohet në Nenin 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> |

| | |
|----|--|
| 47 | <p>1.2.2.3.2. kolaterali është kapital jolikuid</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni dhe ku transaksioni është kapital jolikuid i kolateralizuar.</p> |
| 48 | <p>1.2.2.3.3. gjithë kolaterali tjetër jolikuid</p> <p>Neni 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë ku kundërpala nuk është bankë qendrore dhe ku transaksioni është i kolateralizuar nga asete jolikuide që nuk janë përfshirë deri më tani në zërin 1.2.2.3.1 ose 1.2.2.3.2.</p> |
| 49 | <p>1.3. Gjithsej rrjedhat hyrëse nga kundërkëmbimet e kolateralit</p> <p>Bankat do të raportojnë këtu shumën e gjithsej rrjedhave hyrëse nga kundërkëmbimet e kolateralit siç llogaritet në formularin mbi Kundërkëmbimet e Kolateralit.</p> |
| 50 | <p>1.4. (Diferenca ndërmjet gjithsej rrjedhave hyrëse të peshuara dhe gjithsej rrjedhave dalëse të peshuara nga transaksionet në vendet e huaja ku ekzistojnë kufizime të transfereve ose të cilat janë të denominuara në valuta jokonvertibile)</p> <p>Neni 25 paragrafi 8 i Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet</p> <p>Bankat do të raportojnë në Kolonën 6 shumën e gjithsej rrjedhave hyrëse të peshuara nga vendet e huaja ku ekzistojnë kufizime të transfereve ose që janë të denominuara në valuta jokonvertibile duke zbritur shumën e gjithsej rrjedhave dalëse të peshuara nga vendet e huaja ku ekzistojnë kufizime të transfereve ose të cilat janë të denominuara në valuta jokonvertibile siç raportohet. Në rast se kjo shumë është negative, bankat do të raportojnë “0”.</p> |
| | <p>ZËRA MEMORANDUMI</p> |
| 51 | <p>2. Rrjedhat hyrëse nga këmbimi valutor</p> <p>Ky zë memorandum do të raportohet nga banka vetëm në rast të raportimit të ndarë të valutës raportuese ose të valutës e cila është e ndryshme nga valuta raportuese në rastet kur detyrimet agregate në</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>valutën e ndryshme nga euro arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithsej detyrimeve të bankës.</p> <p>Bankat do të raportojnë pjesën e rrjedhave hyrëse nga derivativët (të raportuar në zërin 1.1.9.) që lidhen me rrjedhat e principalit të këmbimit valuator në valutën përkatëse nga kundërkëmbimet valutore të kryqëzuara, këmbimit valutor aktual dhe transaksionet me pajtim paraprak (ang. forward) që maturojnë brenda periudhës 30 ditore. Netimi nga kundërpala mund të aplikohet vetëm në rrjedhat në atë valutë.</p> |
|--|---|

PJESA 4

KUNDËRKËMBIMET E KOLATERALIT

1. Udhezime të përgjithshme

- 1.1. Çdo transaksion që maturon brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike ku asetet jo në para të gatshme kundërkëmben për asete tjera jo në para të gatshme, do të raportohen formularin mbi kunderkëmbimet e kolateralit. Zërat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë të hijezuara me ngjyrë të hirtë.
- 1.2. Transaksionet e kundërkëmbimit të kolateralit që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike do të krijojnë një rrjedhë dalëse nëse aseti i huazuar është subjekt i një faktori zvogëlues më të ulët sipas Kapitullit 2 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet sesa aseti i dhënë hua. Rrjedha dalëse do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e tregut të asetit të huazuar me diferencën ndërmjet normës së rrjedhës dalëse që zbatohet për asetin e dhënë hua dhe normën e rrjedhës dalëse që zbatohet për asetin e huazuar në transaksionet e financimit të siguruara që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike. Në rastin kur kundërpala është banka qendrore vendore e bankës, norma e rrjedhës dalëse që duhet të aplikohet për vlerën e tregut të asetit të huazuar do të jetë 0%.
- 1.3. Kundërkëmbimet e kolateralit që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike do të krijojnë një rrjedhë hyrëse nëse aseti i dhënë hua është subjekt i një faktori zvogëlues më të ulët sipas Kapitullit 2 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet sesa aseti i huazuar. Rrjedha hyrëse do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e tregut të asetit të dhënë hua me diferencën ndërmjet normës së rrjedhës hyrëse të aplikueshme për asetin e huazuar dhe normës së rrjedhës hyrëse të aplikueshme për asetin e dhënë hua në transaksionet e kredituara të siguruara që

maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike. Nëse kolaterali i marrë përdoret për të mbuluar pozicionet e shkurta që mund të zgjaten përtej 30 ditëve kalendarike, asnjë rrjedhë hyrëse nuk do të njihet.

1.4. Për asetet likuide, vlera e likuiditetit llogaritet në pajtueshmëri me Nenin 9 të Rregullores për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet.

